



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
RFUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 shkronja c), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, nenit 5 dhe 6 të Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.464-264 të datës 23.03.2009, nenit 4 dhe nenit 8 të Kontratës së datës 18.09.2009 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës në ZK Banullë-pasuri shoqërore e KK Lipjan, Fondacionit të Dijanetit të Turqisë-Institucionet Shëndetësore 29 Maji, në mbledhjen e mbajtur me 18. 12. 2015, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratoi këtë :

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL NR.464-264 TË DATËS 23.03.2009 DHE SHKËPUTJEN E KONTRATËS SË DATËS 18.09.2009 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË TOKËS NË ZK BANULLË-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, FONDACIONIT TË DIJANETIT TË TURQISË- INSTITUCIONET SHËNDETËSORE 29 MAJI

Neni 1

Me këtë vendim anulohet Vendimi i Kuvendit Komunal Nr.464-264 i datës 23.03.2009 dhe shkëputet Kontrata e datës 18.09.2009 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës-ngastrës kadastrale P-71409003-00926-0 në vendin e qujtur "Rosula" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 2.80,18 ha në ZK Banullë-pasuri shoqërore e KK Lipjan, Fondacionit të Dijanetit të Turqisë-Institucionet Shëndetësore 29 Maji.

Neni 2

Pas miratimit të këtij propozim-vendimi nga Kuvendi Komunal Lipjan dhe hyrjes së tij në fuqi ngastra kadastrale me të dhënat e cekura në nenin e mësipërm i kthehet në posedim të plotë Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-61558

Lipjan, më 21. 12. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

